



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 116 /2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Ferizajt, në seancën e panelit të mbajtur me 03.05.2012, mori këtë:

VENDIM

- I. PZAP-i shpallet inkompetent për të vendosur në këtë çështjes juridike.
- II. Shkresat e lëndës ti dërgohen Prokurorisë Publike Kompetente në procedurë dhe vendosje të më tejshme.

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 30.04.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se më datën 29.04.2012 rreth orës 17:40, në shkollën “Konstadin Kristoforidhi” në fshatin Nerodime, një person me emrin Mexhide Alija, ka shkuar për të votuar por tek libri përfundimtar i votuesve kishte të nënshkruar emrin e saj. Sipas parashtruesit të ankesës në këtë rast është ndërpre votimi.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës deklaratën e Blerim Maqastenes, në të cilën deklarohet se kryesuesi i vendvotimit nuk e ka tejuar votuesen Mexhide Alija te votoj me pretekst se ajo e ka nënshkrimin në listën e votuesve.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

PZAP- i nuk është kompetent për të vendosur në këtë çështje juridike.

Nga shkresat rrjedh se në këtë çështje ka elemente të veprës penale nga neni 176 i KPK-së dhe lidhur më këtë ka kompetencë për të vendosur Prokuroria Publike Kompetente.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë

A nr. 116 /2012 më datën 03.05.2012.

Kryesuesi i Panelit
Muharrem Shala

